

*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

**22.05.2023
Ora 11:55**

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorëve të kërkesave ankimore nr. 69, 70, 71, 72, 73”.

PJESËMARRJA :

- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot, në datën 22.05.2023 ora 11:55, zhvillohet seanca e shortit për caktimin e relatorit, për kërkesat ankimore nr. 69, 70, 71, 72, 73. Procedura e shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre ku kemi vendosur kërkesat ankimore nr. 69 - 73 të cilat palosen dhe vendosen në 5 gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezent, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së për të térhequr goglat në emër dhe për llogari të tyre sipas rendit alfabetik rritës duke filluar me zotin Elvin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe nw fund zoti Ledio Braho.

Térhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako – Kërkesa ankimore me numër 73.

Térhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - Kërkesa ankimore me numër 69.

Térhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmali - Kërkesa ankimore me numër 72.

Térhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - Kërkesa ankimore me numër 71.

Térhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - Kërkesa ankimore me numër 70.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Në përfundim të procedurës së shortit, relatorët e kërkesave ankimore janë caktuar si më poshtë:

Zoti Elvin Lako – Relator i kërkesës ankimore me numër 73

Zoti Elvis Çefa – Relator i kërkesës ankimore me numër 69

Zoti Ilirjan Rusmali - Relator i kërkesës ankimore me numër 72

Zoti Koli Bele – Relator i kërkesës ankimore me numër 71

Zoti Ledio Braho – Relator i kërkesës ankimore me numër 70

Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

22.05.2023
Ora 12.34

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 61, subjekti ankues Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL)”

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Ilirjan Rusmali, Z. Ledio Braho
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema
- **Parti politike** PLL (Shpëtim Axhani, Ferid Nela)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. L. Braho: Çelim seancën e shqyrtimit të elementeve dhe të formës së kërkesës ankimore nr. 61/1, të depozituar nga Partia Lëvizja e Legalitetit. Kërkesa tashmë përmban nr. 61/1 për shkak të ridepozitimit të saj nga Partia Lëvizja e Legalitetit sipas formatit të kërkesave ankimore të miratuara nga KQZ-ja. Në kërkesën e palës kërkohet shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve në QV-të nr. 1885, dy herë 1885, dhe 1537 e të tjerë të njësisë zgjedhore Bashkia Tiranë. Kërkohet që edhe në Bashkinë Dibër, në shkollën Maqellarë, kutia me numër 1100 nuk është numëruar dhe nuk është llogaritur në ndarjen e mandateve. Po ashtu kërkon edhe për Bashkinë Përrenjas se është vënë dorë, votat e pavlefshme janë ndarë mes subjekteve që kanë pasur përfaqësues në GNV; në Bashkinë Elbasan rezultati nuk përputhet. Tashmë, nga ajo çka kuptojmë ne këtu rezulton se kërkohet të ankimohet rezultati për tre bashki të ndryshme: Tiranë, Dibër, Përrenjas. Referuar neneve 122 dhe 123 të Kodit Zgjedhor për Bashkinë Tiranë duhet të miratohet tabela përbledhëse me vendim të

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, meqenëse ka më shumë se një KZAZ, ndërkokë që për Dibrën dhe Përrenjasin duhet të jenë vendime të KZAZ-ve që ankimoren për sa i përket tabelës përbledhëse. Nga kërkesa ankimore, edhe pse i është lënë kohë e duhur nga KAS-i, nuk shohim të reflektohen numrat e vendimmarrjeve përkatëse, të bashkëlidhen vendimet dhe të ketë ndonjë provë në lidhje me pretendimet që ngre ankuesi. Zoti sekretar i Përgjithshëm, meqenëse ju jeni i pranishëm dhe shohim që pala nuk është e pranishme, pavarësisht...

Z. Y. Merkaj: Është duke ardhur.

Z. L. Braho: Atëherë presim 5 minuta, meqenëse njoftohemi që pala po vjen, që t'i japim kohë edhe palës.

Shoh që një person hyri në sallën e KQZ-së ku po zhvillohet seanca për shqyrtimin e elementeve të formës dhe të përbajtjes së kërkesës nr. 61, depozituar nga Partia Lëvizja e Legalitetit. Ju lutem, na u prezantoni si fillim kush jeni.

Z. F. Nela: Unë jam përfaqësuesi i Legalitetit, Ferit Nela.

Z. I. Rusmali: Keni autorizim?

Z. F. Nela: Po kam qenë edhe herë të tjera.

Z. L. Braho: Herë të tjera do të thotë zgjedhje të tjera, apo?

Z. F. Nela: Për këto zgjedhje, por në seanca të tjera.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. I. Rusmali: A jeni përfaqësues i autorizuar?

Z. F. Nela: Po. Do të vijë edhe kryetari për dy minuta.

Z. L. Braho: Po pra, por ne lëmë orare. Jo më kot lëmë orare, të vijnë në orar. Derisa edhe ne vijmë në orar, duhet të jeni edhe ju. A e kuptioni se sa ankesa mund të jetë kështu si e juaja këtu? Dhe po të shtyjmë të gjitha duke pritur rrimë këtu ne pastaj. Atëherë, deri sa të vijë kryetari, meqenëse ju thoni se jeni përfaqësues keni ridepozituar kërkesën që ka marrë numrin 61/1 dhe ngrini pretendime në lidhje me rezultatin për tri bashki: Bashkinë Tiranë, Bashkinë Përrenjas dhe Bashkinë Dibër. Tani ju vazhdoni dhe i qëndroni kërkesës për të tri bashkitë?

Z. F. Nela: Po, i qëndrojmë.

Z. L. Braho: Po çfarë vendimesh ankimoni ju? Cilat janë vendimet që ankimoni ju?

Z. F. Nela: Vendimet janë depozituar dje me sa di unë.

Z. L. Braho: Ne nuk kemi vendime fare këtu. Ne kemi këtë letrën që pretendohet se në disa qendra votimi rezultati që ju keni nuk përputhet me atë që kanë nxjerrë KZAZ-të.

Z. F. Nela: Kjo është një nga arsyet që ne kemi bërë kërkesë për mospranim rezultati.

Z. L. Braho: Tani edhe njëherë se nuk mund ta zhvillojmë seancën kështu. Cila është arsyja, nuk keni vendimet?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. F. Kica: Nuk jemi dakord me ato rezultatet për këto qendra.

Z. L. Braho: Po cili është rezultati? Ku e dimë ne rezultatin? Ku jeni bazuar ju që nuk jeni dakord me rezultatin? A keni vendimin që janë miratuar rezultatet për Tiranën, për Përrenjasin, për Dibrën?

Z. A. Kica: Kemi rezultatin e KZAZ-ve, të cilat të gjitha kutitë e votimit, ose qendrat e votimit që janë deklaruar tek kërkesa që keni përpara, ka pasur probleme me anëtarët dhe kryetarët e KZAZ-ve, sepse nuk kanë pranuar për të hapur dhe nuk e kanë vënë atë numër apo shifër që ka dalë për kutitë e votimit për Partinë e Legalitetit. Unë jam Afrim Kica, përfaqësues i Legalitetit, i pari në listat e Tiranës, kandidat për këshillin bashkiak dhe i kam ndjekur vetë dhe ato të gjitha janë të ndara në të gjitha qendrat e votimit.

Z. L. Braho: Po mirë tani ky procesi që ne bëjmë këtu është një proces administrativ, që ne duhet të kemi disa prova, se ne nuk mund të bazohemi vetëm në fjalën tënde dhe të hapim të gjitha kutitë, apo ta kalojmë për shqyrtim. Së pari, ne na mungojnë vendimet; së dyti, këtu është bërë një ankım që përfshin tri bashki të ndryshme. Tabelat përbledhëse të rezultateve të Bashkisë së Tiranës miratohen nga Kómisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kurse Dibra dhe Përrenjasë miratohen nga KZAZ-të përkatëse. Tani ju keni shkruar 5 fjalë këtu, asnje provë, as vendime dhe asgjë, edhe pse ju lamë kohë për t'i plotësuar dhe sot gjendemi në të njëjtën situatë. Tani si ta çojmë para këtë proces pa asnje provë?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. A. Kica: Provat me sa di unë duhet t'i ketë sjellë kryetari. Vendimet që janë marrë janë marrë për ato tri- katër qendra që duhet të jenë në përplasje me anëtarët e KZAZ-ve, sepse nuk jepnin asnje lloj sqarimi. E vtmja gjë që na thanë është ardhja tek ju, sepse nuk pranoni. Ne do të ankohemi do t'i nxjerim ato votat që pretendojmë që janë të manipuluara.

Z. L. Braho: Zoti Ylli, a mund të më sqarosh pak datat e vendimeve për Përrenjasin, Dibrën dhe Tiranën?

Z. Y. Merkaj: Për KZAZ-në Përrenjas vendimi nga KZAZ-ja vendimi për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultatit është marrë me datën 16 maj 2023 me numër 170, ndërsa për KZAZ-në Dibër, e ka marrë më datë 17. 05.2023.

Z. L. Braho: Atëherë, janë tri vendime që duhet të ankimoheshin jo një, siç e keni bërë ju. Ju keni ankimuar për rezultate qendrash votimi. Tani, po ju shpjegoj se si duhet të ishte bërë situata. Se pse ju kanë thënë ata të KZAZ-së këtë nuk e marr përsipër ju. Pra, duhet bërë një ankim për Tiranën, që fillon afati nga data 21; një ankim për Përrenjasin, që fillon afati nga data 16 maj dhe një për Dibrën 17 maj. Dhe të vihet edhe me provat përkatëse, se nuk mund të hapen kutitë siç e pretendoni ju. Pra, përveç faktit që mungojnë vendimet nuk ka asnje provë që t'i bashkëlidhet kërkesës ankimore. Ju jeni kryetari? Tani këto po prezantojnë që ju keni sjellë provat këtu. A keni sjellë ndonjë provë?

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Faleminderit! Tani sa i përket Bashkisë Dibër, ne nuk kemi kërkuar numërim ose rinumërim votash, por kemi kërkuar numërim të qendrës së votimit 1100, e cila na rezulton që nuk është parashikuar në përllogaritjen

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

e rezultateve, sepse anëtarët e KZAZ-së në këtë qendër votimi kanë mbajtur një procesverbal ku shihet që vula është e dëmtuar dhe për këtë arsy nuk janë numëruar votat dhe ky procesverbal i është përcjellë KQZ-së që kjo kuti të numërohet pranë KQZ-së. Ne kërkojmë si subjekt zgjedhor që kjo kuti 1100, që është pranë shkollës së Maqellarës të numërohet pranë KQZ-së.

Z. L. Braho: Dakord, por kjo nuk është fare në objektin e KAS-it. Ylli, a ke informacion për këtë? A ka ardhur ndonjë kuti nga Dibra për numërim këtu e dëmtuar?

Z. Y. Merkaj: Tani miratimi i tabelës së KZAZ-së Dibër, ose shpallja e fituesit do të bëhet ditëne sotme, kështu që nuk i kemi parë akoma. Do të shikohet pretendimi që kanë dhe a është përfshirë QV-ja numër 1110.

Z. L. Braho: Po mirë, ti na the që Dibra është miratuar me 17 maj.

Z. Y. Merkaj: E ka miratuar KZAZ-ja. Atëherë vijnë këtu dhe Komisioneri shpall fitues.

Z. L. Braho: Miratimin e tabelës kush e bën?

Z. Y. Merkaj: E bën KZAZ-ja e Dibrës.

Z. L. Braho: E bën KZAZ-ja e Dibrës, por KZAZ-ja e Dibrës e ka bërë miratimin e tabelës pa e përfshirë këtë kuti.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Këtë nuk mund ta them tani, duhet ta verifikojmë.

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Për Përrenjasin faktikisht është ashtu siç edhe ju thatë, thjeshtë vëzhguesi ynë i KZAZ-së që ka qenë prezent ne qendrat e numrit të votave sot na rezulton se në procesverbalet që hidhen, duke pasur parasysh atë që është parë në ekran, në procesverbal rezulton që nuk hidhen votat e pavlefshme. Duke mos u hedhur votat e pavlefshme ose duke u ndarë mes subjekteve të tjera rezulton që normalisht është ndjekur si të thuash ka ndikuar në rritjen e shumatoreve të votave të partive që kanë pasur mandat dhe nuk kemi arritur të marrim mandat. Deri këtu jemi nuk ka afat tjetër. Kjo është e Përrenjasit.

Z. L. Braho: E kuptova. Po për Tiranën?

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Për Tiranën përsëri nga prezenca e vëzhguesve tanë pranë disa qendrave të votimit na është thënë në moment se në iks qendër votimi, ju e keni përparrë atje, rezulton që numri i votave të vërejtura në ekran me numrin e votave të hedhura në procesverbal ka disproporcion. Është kërkuar direkt në KZAZ rinumërimi i kutisë dhe kanë thënë se nuk është kompetencë e jona, drejtojuni KQZ-së.

Z. L. Braho: Zoti Ylli, a u mor vesh gjë për rastin e Dibrës?

Z. Y. Merkaj: Ja, po pres të vijë konfirmimi.

Z. L. Braho: Si procedurë, si është? Pra, për kutitë që nga KZAZ-ja konsiderohen të dëmtuara, numërohen këtu?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Jo kutitë që vijnë nga qendrat e votimit drejt KAZA-së pasi mbaron procesi i votimit, ngrihen grupe pune që marrin në dorëzim materialet në qendër votimi. Kutia, e cila, që në këtë moment shpallet e parregullt nuk i nënshtronhet as numërimi dhe nuk futet në numërim. Kutitë që merren në dorëzim si të rregulla për çdo lloj arsyje pastaj, nëse i mungon ndonjë vulë a kod, numërohen dhe futen tek tabelimi i rezultatit në një nga qendrat e votimit. Pra, nëse kjo është shpallur e parregullt nuk...

Z. L. Braho: Nëse kjo kuti është e parregullt nuk është llogaritur? Nuk numërohet fare?

Z. Y. Merkaj: Nuk numërohet fare.

Z. L. Braho: Dhe i bie që pala që ankohet dhe këtë mund ta bëjë vetëm KAS-i në këtë rast.

Z. I. Rusmali: Për Përrenjasin ju nuk keni asnje provë? A do të térhiqni kérkesën ankimore për Përrenjasin?

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk e kuptova.

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Por, përderisa edhe Kodi edhe neni që parashikon që duhet të kesh prona të pakontestueshme normalisht që ...

Z. I. Rusmali: Atëherë, ju do të térhiqni Përrenjasin.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 8

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. I. Rusmali: Atëherë, jua lëmë Tiranën ta çmojnë vetë, kalojmë për shqyrtim Dibrën. Ta çmojnë vetë, sepse kanë ende kohë për t'u ankuar, të mbledhin provat, të sigurojnë provat, dhe të paraqiten.

Z. Y. Merkaj: Kërkesa ankimore 65, që është e të njëjtë objekt si 61 –shi për Dibrën, edhe 66 ka për Tiranën.

(Diskutime pa mikrofon)

Po dhe 66-ta është Tirana, që është e njëjta kërkesë.

Z. I. Rusmali: Edhe njëherë, kërkesa për Tiranën është bërë para se të dilte vendimi i Komisionerit për shpalljen e rezultatit.

Z. Y. Merkaj: Po, është kërkesa numër 61. Kërkesa ankimore numër 66 është e njëjta me 61-shin. Ka të njëjtin objekt.

Z. I. Rusmali: Pra, Tiranën e kemi me numër 66?

Z. Y. Merkaj: Tiranën e kemi me numër 66 dhe Dibrën e kemi me numër 65.

Z. I. Rusmali: Dakord. Atëherë, rrezojmë kërkesën dhe vazhdojmë tek të tjerat, se Dibrën e paskan ribërë. Rrëzoje të gjithë kërkesën.

(Diskutime pa mikrofon)

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 9

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. Y Merkaj: Dibrën.

(Diskutime pa mikrofon)

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: T'jua sqaroj. Fillimi sh i kemi bërë të tria të përfshira në një anikimim, pastaj këtu na është thënë që do t'i ndani veç e veç. I njëjtë objekt.

Z. E. Lako: Duhet të tërhiqeni.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju kuptova. Për të njëjtin objekt njëren kërkesë duhet ta tërheqim dhe njëra qëndron. E kuptova.

Z. L. Braho: Atëherë, KAS-i i konsultuar në vend vendos: Atëherë meqenëse vetë pala kerkoi pushimin e kësaj kërkese ankimore meqenëse këto kërkesa ankimore janë ridepozituar në vete nga i njëjti subjekt zgjedhor KAS-i i konsultuar në vend vendosi pushimin e shqyrtimit të kërkessës ankimore numër 61, të datës 19.05.2023. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit të Tiranës brenda 5 ditëve nga njoftimi i tij. Deklarojmë seancën të mbyllur.

Vendimi nr. 119

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

 10

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

**DATA 22.05.2023
Ora 12.55**

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 64, subjekti ankues
Partia Lëvizja e Legalitetit”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** **Z. Elvin Lako, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.**
- **Stafi KQZ:** **Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.**
- **Parti politike:** **PLL (Z. Shpëtim Axhani, Z. Nazif Sulaj)**

Z. E. Lako: Çelim seancën publike të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, për verifikimin e plotësimit të elementeve të formës dhe përbajtjes për ankimin numër 64 të subjektit ankues Partia Lëvizja e Legalitetit, me objekt kundërshtimin e vendimit numër 15, datë 16.05.2023 të KZAZ-së numër 27 për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e këshillit bashkiak, Kamzë. Relatori i kësaj seancë jam zgjedhur unë Elvin Lako, sipas shortit të hedhur më datë 20 maj të vitit 2023. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, përbëjnë kuorumin 3 anëtarë. Kështu që është e vlefshme mbledhja; sekretari i Përgjithshëm, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ju lutem me mikrofon, të prezantohet përfaqësuesi i subjektit ankues.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. N. Sulaj: Përshëndetje unë jam Nazif Sulaj, kandidat për anëtar të kësillit bashkia në Kamzë, kryetar i degës së Partisë Lëvizja e Legalitetit për Kamzën dhe sekretar organizativ i kësaj partie.

Z. E. Lako: Jeni me autorizim?

Z. N. Sulaj: Tani, kemi bërë ankesën.

Z. E. Lako: Po pra, ju këtu jeni me autorizim, se që jeni anëtar i këshillit bashkiak, dakord.

Z. N. Sulaj: Kandidat.

Z. E. Lako: Po, kandidat. Këtu jeni si përfaqësuesi i subjektit Lëvizja e Legalitetit. Jeni me autorizim, apo do të përfaqësoheni nga kryetari? Si do ta bëni?

Z. N. Sulaj: Unë mund të flas vetë, domethënë, për...

Z. E. Lako: Do të flasësh vetë, kryetari është këtu, deklaron që do të jetë përfaqësues me deklarim, si do ta bëni?

Z. N. Sulaj: Me deklarim, me gojë.

Z. E. Lako: Mirë, një kartë identiteti, ju lutem, dorëzojeni pastaj tek administrata. Duke pasur parasysh se sot kemi të bëjmë me plotësimin e elementeve të formës dhe përbajtjes jo me thelbin e çështjes, pra, a është bërë në rregull ankimi, a

*Zbardhi materialin audio
Miqgjina LEKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

legjitimoheni ju pér tē bérë kérkesën, a éshtë KAS-i kompetent? Kjo éshtë seanca e sotme, do tē flasim vetém rreth kësaj çështjeje, jo në lidhje me themelin dhe argumentet që keni ju mbi themelin e çështjes. Zoti sekretar i Përgjithshëm, shkurtimisht dy fjalë në lidhje me plotësimin e elementeve tē formës dhe tē përbajtjes pér këtë kérkesë.

Z. Y. Merkaj: Në Komisionin Qendror tē Zgjedhjeve éshtë paraqitur kérkesa ankimore me nr. 64 me ankues Partia Lëvizja e Legalitetit, e cila ankon vendimin e KZAZ-së nr. 19 tē Bashkisë së Kamzës pér tabelën përbledhëse tē rezultatit. Duke parë elementet formale tē parashikuara në nenet 126 dhe 130 tē Kodit Zgjedhor vërejmë se kérkesa nuk i përbush elementet e formës dhe tē përbajtjes, pasi i mungon legjimiteti i ankuesit pér ngritjen e kësaj kérkesë, pasi referuar nenit 123 pikës 1 tē Kodit Zgjedhor KQZ-ja verifikon nxjerr rezultatet e votimit pér zonën zgjedhore apo pér njësinë vendore, territori i tē cilit éshtë i ndarë në dy ose me shumë KZAZ. Bashkia e Kamzës ka dy KZAZ, KZAZ-të 28 dhe 29, kështu që miratimi i tabelës bëhet nga Komisioneri dhe ankimi duhet tē bëhet kundër vendimit të Komisionerit, jo kundër vendimit tē KZAZ-së. Në këto kushte kérkojmë pushimin ose moskalimin e kérkesës pér shqyrtim. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit, zoti Merkaj! Pala ankuese, çfarë keni pér tē thënë? Pra, edhe një herë në lidhje pér plotësimin e elementeve dhe formës dhe përbajtjes. Pra, a legjitimoheni? Pér këto që dëgjuat.

Z. N. Sulaj: Të nderuar zotérinj, unë nuk e di se cili ligj ma ndalon, domethënë që tē kérkoj tē drejtën time ose tē drejtën e votuesve tē mi, tē cilët unë i përfaqësoj. Siç e keni vënë re, domethënë, votimi ka qenë elektronik në Bashkinë e Kamzës.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Komisioneri 2-3 ditë përpara në një media publikisht ka deklaruar, zoti Celibashi, që ku është votimi elektronik rezultati do të dalë brenda një ore pas mbylljes së qendrave të votimit. Ne e kemi ndjekur nga faqja publike e KQZ-së rezultatin dhe në datën 15.05.2023 në orën 3 e një çerek ka dalë rezultati, ku subjekti Partia Lëvizja e Legalitetit kishte 1008 vota, rezultat që do të thotë se do të përfaqësohet me një anëtar në këshillin bashkiak të Kamzës. Të nesërmen, duke besuar tek institucioni i KQZ-së, nuk është se e kemi ndjekur dhe mbas dite nga miqtë jemi njoftuar që ka ndryshuar rezultati dhe është zeruar. Pasi e kemi parë, domethënë te faqja e KQZ-së është zeruar një qendër votimi dhe rezultati ynë ishte 999 vota, ku mandati diskutohej midis nesh dhe një subjekti tjeter.

Z. E. Lako: Ju lutem, nuk po kuptohemi. Këto janë argumentet që kanë të bëjnë me themelin e çështjes. Nuk jemi në atë seancë, jemi në seancën a do ta kalojmë për ta shqyrtuar apo jo, që do të thotë: a plotësohen elementet e formës dhe të përbajtjes së kërkesës që KAS-i ta shqyrtojë këtë çështje? Nëse ne vendosim ta kalojmë për shqyrtim, në seancën tjetër të themelit do të diskutojmë për themelin. Ne jemi të plotësimi i elementeve të formës. Nga ana e administratës u tha që Kamza ka 2 KZAZ dhe sipas nenit 123 të Kodit Zgjedhor ju duhet të prisni rezultatin që shpallet nga Komisioneri dhe atë të ankonit dhe jo vendimin e një KZAZ -je. Pra, ju mungon legjimiteti në këtë moment që ne po flasim, është qëndrimi nga administrata. Keni për të thënë gjë me këtë pretendim, apo nëse nuk keni për të thënë gjë ne vazhdojmë me...

Z. N. Sulaj: Me sa informacion kam unë nga faqja zyrtare e KQZ –së, Komisioneri e ka shpallur rezultatin para 2 ditësh dhe unë nuk e di se ku duhet t'i bëj ankimet

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

e mia, këtu apo ku duhet t'i bëj? Ndoshëta unë nuk jam jurist që ta njoh formën e ligjit, por jam një qytetar...

Z. E. Lako: Nëse janë shpallur nga Komisioneri duhet të ankoheni kundër vendimeve të Komisionerit, jo kundër vendimit të KZAZ-së.

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: E kuptuam drejt, ne duhet të kundërshtojmë vendimin e marrë dje nga Kryekomisioneri, që ka shpallur rezultatet e Kamzës. Do të depozitojmë po sot ankimin e ri. Nga kërkesa nuk tërhiqemi, merret vendim që për këtë arsy e hodhëm poshtë.

Z. I. Rusmali: Edhe një herë, tërhiqeni nga kjo, bëni tjetrën, apo jo?

Z. E. Lako: Nëse ju e kuptuat.

Z. N. Sulaj: Ne duam vendim.

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Më mirë të hidhet poshtë me vendim, në qoftë se ekziston kjo.

Z. E. Lako: Ne patjetër do të shprehemi me vendim, po qëndrimit tuaj do t'i vijë radha. Ju lutem, të flasë njëri, sepse jeni 2 përfaqësues, sikur jeni 2 palë. Cili është qëndrimi përfundimtar, pastaj meqenëse ...

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Jemi kuptuar drejt. Pra, sekretari i Përgjithshëm thotë objekti duhet të jetë kundërshtimi i vendimit.

*Zbardhi materialin audio
Mërgjina LEKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. E. Lako: Sekretari i Përgjithshëm përfaqëson KQZ-në, ju përfaqësoni subjektin tuaj.

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: KQZ-ja thotë ky ankimi duhet të ishte drejtuar pas daljes së vendimit të Kryekomisionerit dhe ky ankım nuk duhej t'i drejtohej KZAZ-së Kamëz, se Kamza ka 2 KZAZ. Kjo dihet. Atëherë, ne normalisht presim vendimin e KAS-it kundrejt kësaj që tha KQZ –ja për ju.

Z. E. Lako: Atëherë, shkurtimisht dhe një herë, zoti Ylli, ju çfarë kërkon?

Z. Y. Merkaj: Moskalimin e kërkesës në seancë për shqyrtim.

Z. E. Lako: Moskalimin, dhe ju pala ankuese çfarë kërkon?

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Do të presim vendimin e KAS-it.

Z. E. Lako: Mirë, faleminderit! Do të tèrhiqemi për vendim.

Z. Y. Merkaj: ...vendimi për miratimin nga KZAZ-së. KZAZ-ja për disavantazh miraton tabelën përbledhëse të asaj zonë zgjedhore, të asaj KZAZ-je.

Z. E. Lako: Atëherë, në përfundim të hetimit KAS-i vendosi mospranimin e kërkesës për shkak të mungesës së elementeve të përcaktuara në nenin 130 të këtij Kodi. Kundër këtij vendimi mund të bëni ankım në Kolegjin Zgjedhor brenda 5

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

ditëve. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Me kaq e deklaroj të mbyllur këtë seancë.

Vendimi nr. 120

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

22.05.2023
Ora 13:04

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 65, subjekti ankues PLL”.

PJESËMARRJA:

- **KAS-i:** Z. Elvin Lako, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi i KQZ-së:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Parti Politike:** Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së:
- **Të tjera:** KRIIK

Z. E. Lako: Çelim seancën për çështjen nr. 65. Përsëri është i njëjtë subjekt ankues, Partia Lëvizja e Legalitetit, ku kundërshtohet vendimi nr. 325, datë 17.05.2023 i KZAZ-së nr. 19, për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e këshillit bashkiak së Bashkisë së Dibrës. Relatori i kësaj seance jam zgjedhur unë, Elvin Lako, sipas shortit të hedhur në datën 20 maj. Të pranishëm, siç e theksuam, janë anëtarët e Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve, sekretari i Përgjithshëm, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përsëri është subjekti ankues Partia Lëvizja e Legalitetit, që do të përfaqësohet nga kryetari i saj. Zoti Merkaj, shkurtimisht dy fjalë në lidhje me këtë çështje.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa ankimore nr. 65, me kërkues Partia Lëvizja e Legalitetit, e cila ankimon vendimin

*Zbardhi materiali audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

e KZAZ-së nr. 19 Dibër në lidhje me mospërfsfirjen e një qendre votimi dhe konkretisht qendra e votimit Maqellarë me nr. 1100, në tabelën përbledhëse të rezultatit të kësaj KZAZ-je. Bashkëlidhur ankimit është paraqitur edhe vendimi për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultatit, e cila është firmosur nga 6 vota pro dhe 1 kundër, dhe i mungon tabela përbledhëse e rezultatit. Duke parë elementet formale të kërkesës mendojmë që mund të kalojë për shqyrtim pasi tabelën përbledhëse e ka KQZ-ja dhe ia kemi vënë në dispozicion KAS-it.

Z. E. Lako: Faleminderit, zoti Merkaj! Nga pala ankuese keni ndonjë gjë për të thënë në këtë fazë? Prapë jemi te plotësimi i elementeve të formës dhe përbajtjes.

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Ju kemi thënë, siç e thatë, pranohet kërkesa jonë për numërimin e qendrës së votimit nr. 1100.

Z. E. Lako: Në këtë fazë jemi në kërkesën tuaj, që të kalojë për shqyrtim.

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Patjetër, po.

Z. E. Lako: Pra, ju kérkon që kjo të kalojë për shqyrtim. Faleminderit!
Po zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Ju referoni në kërkesën tuaj ankimore, që keni bashkëlidhur procesverbalin e KZAZ-së nr.19, për dëmtimin e kutisë së votimit për qendrën e votimit nr. 1100. Nuk e kam këtu unë, e keni depozituar? Prosesverbalin e KZAZ – së nr. 19 për dëmtimin e kutisë së votimit për qendrën e votimit 1100 e dispononi? Dakord. E dini që duhet të provoni përpara trupës se kutia që nuk është numëruar,

*Zbardhi materiali audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

sipas jush, është e rregullt, se nuk janë automatike këto? Nuk shkojmë në numërimin neve, në qoftë se ju nuk na bindni që kutia ka qenë e rregullt, e keni të qartë?

(Vjen zoti Elvis Çafa)

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Atëherë, i bie që ne të gjejmë edhe kush e ka dëmtuar kutinë?

Z. I. Rusmali: Jo, nuk ka rëndësi se kush e ka dëmtuar kutinë, rëndësi ka të na provoni që rezultati brenda në kuti nuk ka pasur mundësi të manipulohet.

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Atë nuk e themi.

Z. I. Rusmali: Po kështu ecet përpara, ligji thotë hapet kutia, në qoftë se bindet KQZ-ja që kutisë nuk i ka ndodhur gjë dhe detyrimin për ta bindur e keni ju. Po jua them në këtë seancë, ta dini.


(Diskutim pa mikrofon)

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Në Dibër kemi marrë 1250 vota, kemi marrë një mandat dhe për shtatë vota është humbur mandati.

(Diskutim pa mikrofon)

Dhe si parantezë dhe në Kamëz ka dalë jashtë përdorimit kutia ku ka votuar vetë kandidati ynë.

*Zbardhi materiali audio
Jona DERVISHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. E. Lako: Ka më pyetje? Atëherë meqë s'ka më pyetje, pretendimet e palëve edhe një herë, zoti Merkaj, që t'i kalojmë për shqyrtim dhe pala është për të kaluar në shqyrtim. KAS-i, i konsultuar në vend, vendosi ta kalojë këtë çështje për shqyrtim dhe seancën e radhës do ta mbajmë nesër në ambientet e KQZ –së, në orën 12 e 30. Pra, nesër në datën 23 maj, në orën 12 e 30. Me kaq e deklaroj të mbyllur seancën. Faleminderit!

Vendimi nr. 121

*Zbardhi materiali audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

22.05.2023
Ora 13.10

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr 66, subjekti
ankues PLL.**

PJESËMARRJA:

- KAS-i: Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- Staffi i KQZ-së: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- PARTI POLITIKE : PLL

Z. L. Braho: Atëherë çelim seancën për shqyrtimin e elementeve dhe të formës të kërkesës ankimore nr. 66 të depozituar në KQZ në datën 20.05.2023 me akuzë subjekti Partia Lëvizja e Legalitetit. Pretendimi ka të bëjë me mospërputhjen e numrit të votave të dala në ekran, me numrin e votave që janë hedhur në procesverbal. Kërkohet rinumërim votash të kutive përkatëse në QV për KZAZ-të 29, 37 dhe 41. Të pranishëm janë kryetari i Partisë Lëvizja e Legalitetit, po ashtu edhe sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së. Si fillim fjala për sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së, në lidhje me elementet e formës dhe të përbajtjes të kësaj kërkesë ankimore.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 66 me ankues Partia e Legalitetit, e cila ankon rezultatin e qendrave të votimit të KZAZ –ve nr. 29, 37 dhe 41. Duke parë verifikimin e elementeve formale të kërkesës konstatohet si në rastin e kërkesës ankimore që ishte Bashkia e Kamzës, që kjo kërkesë kundërshton tabelat e KZAZ –ve, të cilat janë pjesë përbërëse të KZAZ-së madhe të Tiranës që tabela përbledhëse e rezultatit miratohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në këto kushte duke qenë se nuk plotëson legjitimimin, i kërkojmë KAS-it të mos e pranojë kërkesën për shqyrtim, pasi kërkesa mund të drejtohet kundër tabelës përbledhëse për miratimin e Bashkisë së Tiranës. Faleminderit!

Z. L. Braho: Fjala për kryetarin e Partisë Lëvizja e Legalitetit. Çfarë keni në lidhje me elementet e formës dhe të përbajtjes? Pra, nga sekretari i Përgjithshëm pretendohet që jeni në të njëjtat kushte si në Bashkinë e Kamzës. Për Bashkinë e Tiranës tabela përbledhëse është miratuar në datën 21 maj, pra jeni në afat për të ridepozituar ankim në përputhje me ligjin, megjithatë fjala për ju.

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Po, duke respektuar afatet e Kodit Zgjedhor, kundrejt vendimit të KAS-it do të bëjmë ankimin tjetër, patjetër.

Z. L. Braho: Jo, kundrejt vendimit të KAS-it ancohesh në Kolegj, në KAS sillen ose vendimet e KZAZ –së, ose vendimit e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Në rastin e Bashkisë së Tiranës, duke qenë se ka më shumë se një KZA, ankimohet..

Z. Sh. Axhani, Kryetari i PLL-së: Atë do të ankimojmë, pra.

Z. L. Braho: Çfarë do të bëni me këtë që keni sjellë sot, apo e lini në çmim të KAS-it. Dakord. KAS-i i konsultuar në vend vendos moskalimin për shqyrtim në seancë për sa i përket kërkesës ankimore me nr. 66 për shkak të mosplotësimit të elementeve të formës dhe të përbajtjes, më konkretisht të kompetencës së KAS-it për të shqyrtuar këtë kërkesë ankimore. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ në Tiranë. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr.122

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

**22.05.2023
Ora 13.26**

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 63, subjekti ankues Partia Aleanca Demokristiane”

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Ilirjan Rusmali, Z. E. Çefa,
Z. L. Braho
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema
- **Parti politike** Partia Aleanca Demokristiane (Petrit Dedaj)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Deklarojmë të celur seancën për vlerësimin paraprak të kërkesës ankimore me numër 63, datë 19 maj 2023, me subjekt ankimes Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë dhe me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 260, datë 16 maj 2023 të KZAZ-së “Për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e këshillit të Bashkisë Pukë, rinumërimi dhe rivlerësimi i votave të vlefshme dhe të pavlefshme të subjekteve në kutitë e votimit për këshillin në të gjitha qendrat e votimit të KZAZ-së nr. 7, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër. Ndryshimin e tabelës përbledhëse të rezultatit për këshillin e Bashkisë Pukë, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave”. Sipas shortit të hedhur në KQZ, relatori i kësaj çështjeje jam unë caktuar unë anëtari,

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Elvis Çefa. Verifkojmë prezencën. Është prezent trupa e KAS-it, në përbërje të katër anëtarëve. Mungon një nga anëtarët për arsyet objektive, por ky fakt nuk e pengon proceduralisht KAS-in që të vijojë me shqyrtimin e kësaj çështjeje duke qenë se kuorumi është i bërë. Është prezent sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata. Është prezent edhe përfaqësuesi me autorizim i palës ankuese. Ju lutem prezantohuni shkurtimisht emër, mbiemër.

Z. P. Dedaj: Petrit Dedaj, kam garuar për subjektin Aleanca Demokristiane e Shqipërisë.

Z. E. Çefa: Pra, ju jeni edhe kandidati për këshillin bashkiak...

Z. P. Dedaj: Kandidati i listës shumemërore.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Shkurtimisht, zoti Dedaj, a keni ndonjë kërkesë paraprake ose ndonjë vërejtje lidhur me përbërjen e trupës të KAS-it?

Z. P. Dedaj: Nuk kam asnjë vërejtje.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Mund të vazhdojmë me sekretarin e Përgjithshëm, i cili do të na relatojë shkurtimisht kërkesën dhe elemente të formës e të përbajtjes. Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendor të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 63, me ankues Partinë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, e

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

cila ankimon vendimin nr. 260, datë 16.5.2023 të KZAZ-së Bashkia Pukë, me objekt për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultatit për zgjedhjet e këshillit bashkiak, Bashkia Pukë, si dhe rinumërimin dhe rivlerësimin e votave të vlefshme dhe të pavlefshme për subjektet në kutinë e votimit për këshillin e bashkisë për të gjitha qendrat e votimit të ZAZ-së nr.7, Bashkia Pukë. Duke parë elementet formale të kërkesës, konstatojmë që kërkesa nuk u plotëson elementet formale, kështu që i kërkojmë KAS-it kthimin e kërkesës për plotësim, pasi në fazën që jemi nuk mund të kërkojmë rinumërim dhe rivlerësim të votave, pasi, në qoftë se do t'i referohemi nenit 138 të Kodit Zgjedhor, këto vota duhet të janë të caktuara, të identifikuara ose të kontestuara. Në këto kushte i kërkojmë KAS-it kthimin e kërkesës për plotësim për të rregulluar objektin e kërkimit. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Pyetje nga kolegët? Jo. Unë kam një pyetje për palën ankuese. Ju keni pasur vëzhgues në qendrat e votimit?

Z. P. Dedaj: Kemi pasur tre vëzhgues në tre tavolina numërimi.

Z. E. Çefa: A i kanë pasqyruar vërejtjet e tyre në procesverbal, kanë kërkuar që të pasqyrohen vërejtjet?

Z. P. Dedaj: Janë ngritur në këmbë nga ora 11 e mesnatës vëzhguesi i tavolinës nr. 1, vëzhguesi i tavolinës nr. 2 dhe vëzhguesi i tavolinës nr. 3 për parregullsi, por nuk janë marrë në konsideratë nga kryetari i komisionit të ZAZ-së. U kanë thënë largohuni, mos bëni zhurmë, sepse do t'ju nxjerrim jashtë. Ka pasur parregullsi për të cilat unë kam kërkuar që të sjellin kamerat, filmimet nga kjo orë deri në përfundim

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Alma KOLA", located at the bottom right of the page.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

të procesit, në orën 3 të natës, dhe normalisht janë konstatuar parregullsi në qendrat e votimit nr. 425, nr. 415/1, nr. 415, nr. 379 dhe i kam cituar në kërkesë.

Z. E. Çefa: Janë katër qendra votimi ku ju mendoni se ka pasur parregullsi.

Z. P. Dedaj: Janë shtatë qendra votimi ku ka pasur devijim të votave të pavlefshme duke i shpërndarë në tri subjekte zgjedhore, të cilat nuk kanë pasur mandat deri në atë kohë. Unë theksoj faktin që kam pasur mandat online nga KQZ-ja që nga ora 11 e natës deri ditën e martë dhe mua më ka rënë mandati. Ky është fakt.

Z. E. Çefa: Besoj e kuptuat atë çfarë tha sekretari i Përgjithshëm, apo jo, që ju me kërkesën tuaj në këtë fazë nuk mundet të kërkoni rinumërim direkt, por ju mund të kundërshtoni rezultatin përfundimtar dhe pastaj është KAS-i që vendos sesi do të administrojë provat. Në këtë fazë ne po mendojmë t'jua kthejmë kërkesën për të plotësuar objektin në këtë formë. Do t'ju lëmë kohë 24 orë deri nesër ta plotësoni, ndërkohë kjo ju leverdis edhe ju se mund të vijnë edhe imazhet filmike për të cilat keni bërë kërkesë në KQZ, ta plotësoni kërkesën dhe pastaj të vlerësojmë nëse do ta kalojmë për shqyrtim apo jo.

Z. P. Dedaj: Dakord.

Z. E. Çefa: Faleminderit! KAS-i, i konsultuar në vend, vendosi kthimin për plotësim të kërkesës ankimore nr. 63 të subjektit ankimues, duke i dhënë atij 24 orë kohë sipas parashikimeve në Kodin Zgjedhor për të bërë saktësimin e objektit. Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 123

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*


4

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

22.05.2023
Ora 13.40

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 68, subjekti
ankues Partia Aleanca Demokristiane”**

PJESËMARRJA:

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Ilirjan Rusmali, Z. E. Çefa,
Z. L. Braho
- **Stafii KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema
- **Parti politike** Partia Aleanca Demokristiane (Petrit Dedaj)
- **Të tjera:** KRIIK

Z. I. Rusmali: Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 68 të subjektit Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë me objekt: “Kundërshtimin e vendimit të KZAZ-së “Për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultatit të këshillit të Bashkisë Përmet” dhe 2. Rinumërimin dhe rivlerësimin e votave të vlefshme dhe të pavlefshme në kutitë e votimit për këshillin për të gjitha QV-të e KZAZ-së Bashkia Përmet, Qarku Gjirokastër. Ndryshimin e tabelës përbledhëse për rezultatin për këshillin e bashkisë për Bashkinë Përmet, duke përfshirë në rezultatin e dalë nga procesi i rinumëimit dhe rivlerësimit të votave”. Në seancë janë katër anëtarë të KAS-it. Zoti Koli Bele mungon me arsyen ligjshme. Është prezent sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, zoti Ylli Merkaj, së bashku me stafin e

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*


1

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

tij. Gjithashtu, prezent është edhe përfaqësuesi i autorizuar i subjektit. Ju lutem, thojeni edhe një herë emrin.

Z. P. Dedaj: Petrit Dedaj.

Z. I. Rusmali: Faleminderit! Kërkesa paraprake nuk ka. Deklarime nga kolegët nuk ka. Ia jap fjalën sekretarit të Përgjithshëm të bëjë përshkrimin e tij lidhur me elementet formale të kërkesës ankimore.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 68, me ankues Partinë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, e cila kundërshton vendimin e KZAZ-së nr. 76 “Për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultatit për zgjedhjet e këshillit Bashkia Përmet, si dhe kërkon rinumërimin dhe rivlerësimin e votave të vlefshme dhe të pavlefshme për të gjitha kutitë e votimit të qendrave të votimit të ZAZ-së nr.76, Bashkia Përmet. Nga verifikimi i elementeve formale të kërkesës, ashtu siç e relatuam edhe te kërkesa ankimore nr. 63, nuk i plotëson elementet, pasi objekti i ankimit është rinumërimi dhe rivlerësimi i votave. Mendojmë që në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes, kërkesa duhet të kthehet për plotësim, pasi sipas nenit 138 të Kodit Zgjedhor, votat e caktuara janë vota të identikuara dhe të kontestuara sipas neneve 116 dhe 118 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, duke qenë se kërkohet për të gjitha QV-të, pa i përcaktuar votat e caktuara, kërkojmë që kërkesa të kthehet për plotësim. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Përfaqësuesi i subjektit ka ndonjë gjë për të shtuar?

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*


2

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

Z. P. Dedaj: Në këtë fazë unë kam kërkuar që të merren pamjet filmike të orës 11.30 të mesnatës deri në mbyllje të procesit.

Z. I. Rusmali: Dakord. Provat që kërkon nga KQZ-ja nuk keni nevojë t'i kërkonи në KAS, i kërkonи drejtpërdrejt në KQZ, dhe...

Z. P. Dedaj: I kam kërkuar.

Z. I. Rusmali: Dhe KQZ-ja është e detyruar t'jua vërë në dispozicion. Ju tek ne në KAS i sillni të seleksionuara. Pra, në qoftë se kërkohen pamje filmike, ju do të merrni e do të shqyrtoni 10 orë filmime, tek ne do të sillni sekuencat respektive, pra do të thoni që në minutën kaq e në sekondën kaq të këtij materiali gjendet kjo provë, që ne të mund të konsultojmë provën aq, jo t'i shikojmë nga e para. Kjo është një procedurë që ne do ta bëjmë në shqyrtimin në themel. Për subjektet zgjedhore që kontestojnë rezultatin e zgjedhjeve, sipas pikës 2 të nenit 124, Kodi parashikon se kundër vendimit të KAZA-së, siç është në rastin konkret, për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njësive të qeverisjes vendore nën juridikcionin e saj, mund të paraqitet ankim në KQZ, tek ne, jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e tabelës përbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përbajë ndryshimin e tabelës përbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi. Rinumërimi i votave, hapja e kutive dhe rinumërimi në tërësi ose pjesërisht nuk është objekt kërkimi. Rinumërimi është mjet për sigurimin e provës dhe nuk mund të jetë në objektin e kërkuesës. Për këtë arsyen do ishte me vend, edhe në këtë rast, që juve t'ju kthehej kjo kërkuesë dhe të bënë rregullimin e saj në përputhje me nenin 124, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe ta organizonit në përputhje me këtë objekt. Pra,

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimoreve dhe Sanksioneve
Dt.22.05.2023*

edhe provat t'i referoheshin këtij objekti, dhe pretendimet e përshkruara t'i referoheshin këtij objekti. Kanë ndonjë gjë kolegët? Mund ta marrim vendimin në

këtë logjikë. KAS-i, i konsultuar në vend, vendosi që ta kthejë për plotësim edhe këtë kërkesë të dytë të subjektit duke i kërkuar specifisht rregullimin e objektit dhe pastaj në përputhje me objektin edhe përbajtjen në tërsi të kërkesës ankimore brenda 24 orësh nga marrja e këtij vendimi. Keni 24 orë kohë që ta riformuloni, ta përshtatni me pikën 2 të nenit 124 dhe ta sillni përsëri që ne të mund të shqyrtojmë themelin e kërkesës. Faleminderit! Me kaq e myllim edhe këtë seancë. Ju uroj ditë të mbarë!

Vendimi nr. 124

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

